

Floida Kërpaçi

Floida Kërpaçi lindi në Sarandë më 17 Maj 1994 dhe në vitin 2019 është diplomuar për "Master Shkencor në Farmaci", pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Prej Qershorit 2023, ushtron mandatin e dytë si Anëtare e Këshillit Bashkiak, në Bashkinë e Tiranës.

Ajo nisi angazhimin politik në moshën 16 vjeçare, si një gjimnaziste e Petro Nini Luarasit dhe aktiviste e Lëvizjes Rinore për Integrim. Në moshën 21 vjeçare u zgjodh Anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, ndërsa një vit më vonë u zgjodh Kryetare e Lëvizjes Rinore për Integrim, përmes procesit zgjedhor "Një anëtar, një votë", që u mbajt në të gjithë Shqipërinë.

Gjatë mandatit si Anëtare e Këshillit Bashkiak, Znj. Kërpaçi bashkëthemeloi në vitin 2016 "Aleancën e Këshilltarëve të Rinj në Bashkinë e Tiranës", që e drejtoi për një mandat 1 vjeçar, duke përkrahur nisma si të rinjtë dhe të rejtat drejt një profesioni, mbështetjen e studentëve për Kartën e Studentit, për Abonenë e Studentit, si dhe nisma të tjera promovuese për punësimin dhe nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm të gjeneratës së re në komunitet.

Në shkurt 2016, ajo u angazhua në themelimin e "Aleancës së grave dhe vajzave këshilltare", të Bashkisë Tiranë.

Në vitin 2017, u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, si kandidate e Qarkut Tiranë, kohë në të cilën shërbeu edhe si Zëdhënëse e Grupit Parlamentar.

Në Kuvendin e Shqipërisë, ka qenë Anëtare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, Komisionit të Edukimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Nën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës Kundër Grave.

Në dhjetor 2018, Deputetja Kërpaçi ishte propozuese e Amendamenteve Ligjore që nisën procesin legjislativ për plotësimin e 8 kërkesave të studentëve gjatë protestës studentore të vitit 2018.

Gjatë ushtrimit të mandatit të saj si Kryetare e Lëvizjes Rinore për Integrim deri në Shkurt 2024, forumi rinor është angazhuar intensivisht për të çuar përpara kauzat rinore, për më shumë mundësi edukimi e punësimi të rinisë shqiptare. Matura shtetërore gjatë kësaj periudhe ka qenë një nga kauzat kryesore që LRI ka adresuar vazhdimisht, duke çuar propozime konkrete pranë Ministrisë së Arsimit çdo vit, që të garantohej meritokracia, këshillimi i karrierës dhe lidhja sa më e drejtpërdrejtë me tregun e punës.

Në vitin 2022, Znj. Kërpaçi u zgjodh Sekretare për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Partisë së Lirisë.

Më pas, ajo u zgjodh nga Komiteti Drejtues Kombëtar në rolin e nënkryetares së PL.

Znj. Kërpaçi është anëtare e Kryesisë dhe Komitetit Drejtues Kombëtar të Partisë së Lirisë prej vitit 2016.

Në Prill 2019 znj. Kërpaçi u zgjodh 'Ambasadore e Rinisë', prezantuar nga Rrjeti Kombëtar për Të Rinjtë në Shqipëri, me motivacionin se "Znj. Kërpaçi si kryetare e Lëvizjes Rinore për Integrim, si dhe si ish-Deputete në Kuvendin e Shqipërisë dhe ish-këshilltare në Këshillin Bashkiak Tiranë ka avokuar për një seri çështjesh si rritja e Buxhetit të Shtetit për të Rinjtë, rritja e përfaqësimit të të rinjve në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror, si dhe për një arsim publik dhe infrastrukturë cilësore në shkollat e mesme dhe Universitetet në mbarë vendin."

Ajo ka ndjekur një seri trajnimesh dhe aktiviteteve kualifikuese brenda dhe jashtë vendit.

Floida Kërpaçi flet Anglisht, Frengjisht dhe Greqisht.